

Abstrakt

Ky punim trajton temën e garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve në Republikën e Kosovës, duke ofruar një analizë të zgjeruar nga këndvështrimi filozofik dhe kushtetues.

Në pjesën e parë të punimit, analizohen rrënjët historike dhe filozofike të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve, duke u bazuar në teoritë filozofike klasike dhe moderne. Këtu theksohet se njohja dhe mbrojtja e veçantë e të drejtave të komuniteteve, veçanërisht e pakicave nga aspekti moral dhe filozofik është domosdoshmëri sepse kjo siguron dhe garanton ruajtjen e drejtësisë dhe barazisë brenda një shoqërie. Punimi po ashtu trajton ndikimin e ideve të filozofëve të antikitetit, mesjetës dhe të filozofëve modern në hartimin dhe përmbajtjen e kornizave ligjore në funksion të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve.

Në pjesën e dytë, shqyrtohet aspekti kushtetues dhe ligjor i mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve në kontekstin ndërkombëtar, duke përfshirë një analizë të detajuar të akteve ndërkombëtare, të dispozitave kushtetuese relevante dhe mekanizmat institucional përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve si dhe të praktikave të shteteve të ndryshme në këtë fushë.

Në pjesën e tretë fokusi i këtij punimi do të jetë mbrojtja e të drejtave të komuniteteve në Kosovë, duke përfshirë evoluimin e mbrojtjes së këtyre të drejtave në aspektin historik, parimet kushtetuese dhe shqyrtimin analitik të kornizën së përgjithshme legislative, duke filluar me dispozitat kushtetuese, ligjore si dhe mekanizmat institucional për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, efektshmërinë dhe sfidat e këtyre mekanizmave, duke përfunduar me analizën dhe krahasimin e dispozitave kushtetuese të Kosovës dhe vendeve fqinje për të konstatuar nivelin e mbrojtjes kushtetuese të drejtave të komuniteteve të këtyre vendeve në raport me standardet e kërkuara ndërkombëtare në këtë fushë.

Punimi përfundon me analizën dhe krahasimin e gjetjeve kryesore, ofrimin e sygjërimeve dhe rekomandimeve në funksion të përmirësimit të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve me fokus Kosovën por edhe më tej, duke kontribuar në kuptimin më të thellë të rëndësisë së mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe duke ofruar një bazë për zhvillimin e politikave dhe reformave të ardhshme në këtë fushë.

Fjalët kyçe: mbrojtja e të drejtave të komuniteteve, këndvështrimi filozofik, dispozitat kushtetuese, kushtetuta e Kosovës, mekanizmat institucional, standardet ndërkombëtare.